

Krimet naziste ndaj shqiptarëve

Nga një dhomë e errët, e lagësht dhe krejt e vetmuar po dëgjohej një zë. Një e qarë foshnjeje kumbonte në të gjithë shtëpinë e braktisur dhe të larë me gjak. Askush nuk kishte guxim të afrohej ta përkëdhelte dhe ta qetësonte atë foshnje, atë dritë shprese në makthin e errësirës së pafundme. Askush s'e dinte ku ishin prindërit, pse s'gjendeshin aty. Kështu që fati që iu vulos atij fëmije ishte të qenit jetim.

Por çfarë kishte ndodhur vallë me ta? Si mund të ishin zhdukur gjithë të afërmit pa lënë asnjë gjurmë në këtë botë? Pyetja në të cilën mbizotëronte heshtja, ishte "A janë akoma gjallë" ?

Shekulli për të cilin bëhet fjalë, është afërsisht mesi i shekullit të XX diku nga vitet 1940. Në fakt, çdo familje e kishte një shtëpi të braktisur nga e cila dëgjohehin vetëm të qara, simbol i vuajtjeve dhe torturimit. Në një periudhë ku sistemet totalitare kishin në dorë pushtetin nuk dihej seç ndodhte me njerëzit. Disa masakroheshin deri në vdekje, vetëm se ishin hebrenj, disa të tjerë kapeshin si plaçkë luftime, ama fati tragjik ngelej po i njëjti. Kemi dëgjuar histori të shumta të pazakonta dhe çnjerëzore nga Holokausti, por kush do ta kishte menduar që edhe njerëzit tanë, shqiptarët, do të ishin pjesë e viktimave pa e ditur arsyen pse?

E pra, kjo është tragjedia që përcillet nga ato foshnja jetime që ngelën pa nënë e pa baba, që u rritën në dorë të huaj ndërkohë që prindërit e tyre, të djegur nga malli, përballeshin më vështirësitë e një pozite në kampet e përqendrimit që askush s'do ta kishte dëshiruar. Të ngjall të dridhura në trup vetëm duke e imagjinuar.

Një çështje që s'bisedohet, nuk ngrihet zëri a thua sikur të ishte e pavlerë, është pikërisht krimi nazist që shqiptarët kaluan në kampet e përqendrimit. Ata kanë një emër, një identitet: Beqir Xhepa, Kozma Nushi, Xhevdet Doda, Dhimitër Simoni, Ahmetaj Cekaj, Abdulla Krutani, Gaqo Como, Stefan Konduri, Vangjel Doni, Mehmet Agalliu, e shumë të tjerë.

Shumë prej tyre ishin kapur nga forcat fashisto-naziste teksa përpiqeshin të fitonin liri dhe pavarësi për vendin e tyre në luftën antifashiste nacional çlirimtare. Pra, faji i tyre ishte patriotizmi dhe dashuria për atdheun. Kapeshin rob nga forcat e huaja dhe dërgoheshin larg atdheut. Disa ia dolën të mbijetonin, kurse disa të tjerë i'u bashkuan fundit që kishin hebrenjtë, sllavët dhe ciganët.

Mënyra si trajtoheshin ishte makabër. Ushqim i racionuar, ndonjëherë mungonte, ndonjëherë i prishur aq sa mezi e hanin dhe minjtë. Skllavëri dhe kushte të paimagjinueshme higjienë. Pa përmendur dhe eksperimentet që bëheshin me njerëz apo erën mbytëse të kimikateve. Duke "ngordhur" nga uria, edhe qymyri ngjasonte si çokolletë. Askush s'që i sigurt nëse do të mbijetonte të nesërmen.

Kjo foshnje, simbol i rezistencës dhe rinlindjes një ditë do të ngrihej dhe do të vendoste drejtësi e do të kërkonte llogari kundrejt njerëzve që i shkatërruan jetën që në vegjëli. Do të ngrinte zërin për të pohuar dhe informuar njerëzimin mbi veprimet antihumane të nazizmit. Historia na mëson për gabimet e së kaluarës në mënyrë që mos ti përsërisim ato. Jeta e njeriut nuk është një lodër që falet apo merret kollaj.

Diona Ahmetaj

